



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 782 / prot.
12

Gramsh, më 03/06/2021

VENDIM

Nr. 66, datë 28.05.2021

“PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR.95, DATË 28.12.2020 “PËR MIRATIMIN E NUMRIT MAKSIMAL DHE NIVELIT TË PAGAVE E TË SHPËRBLIMEVE TË PUNONJËSVE E PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR TË BASHKISË GRAMSH DHE NJËSIVE VARTËSE TË SAJ, PËR VITIN 2021”

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës 28/05/2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe P/Vendimin “Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur e të emëruar, të Bashkisë Gramsh, për vitin 2021” të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 pika “ç” dhe “dh”; Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Kodi i Procedurave Administrative të RSH; VKM Nr.177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.165, datë 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të vetëqeverisjes vendore”; VKM nr.1149, datë 24.12.2020 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.175, datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë, të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar" të ndryshuar", Vendimin nr.95, datë 28.12.2020 "Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh për vitin 2021" të këshillit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në nivelin e pagave për punonjësit mësimor dhe jomësimor në Konviktin e Shkollës së Mesme dhe Çerdhen e Qytetit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit, miratuar me Vendimin nr.95, datë 28.12.2020 "Për miratimin e numrit maksimal

dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh për vitin 2021" të këshillit, tabela nr.II;

2. Miratimin e nivelit të ri të pagave për punonjësit mësimor dhe jomësimor në Konviktin e Shkollës së Mesme dhe Çerdhen e Qytetit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit, sipas tabelës bashkëlidhur P/Vendimit;
3. Me anë të këtij Vendimi shfuqizohet çdo pikë tjetër e Vendimit nr.95, datë 28.12.2020 "Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh për vitin 2021" të këshillit, që bie në kundërshtim me këtë vendim;
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Tabela përmbledhëse e pagave është pjesë e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Xhulia GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: -/-
Konfirmoi: -/-
Afati i ruajtës: RHK

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Greta LENA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1182/3 prot.

Gramsh, më 23/06/2021

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NIVELI I PAGAVE PËR ADMINISTRATËN E
NJËSITË VARTËSE TË BASHKISË GRAMSH PËR VITIN 2021:

II-Struktura organizative dhe niveli i pagave për Njësitë vartëse të Bashkisë Gramsh (viti 2021).

| 4 DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT (1+8+9+3+8+2+7+73+36) | | | | | | | |
|---|----------------------------------|-------------|---|--------|--------------------------|----------------|------------------------------------|
| Konvikti i shkolles se mesme (1+7) | | | | | | | |
| 4.18 | Pergjegjese konvikti | Larte | 1 | K.Pune | Vkm nr.177, II-b, L.5 | 51750 | PG+(PGX2%)+SHP |
| 4.19 | Kujdestare | Larte | 1 | -//- | Vkm nr.177, III-a/1, L.5 | 45000 | PG+(PGX2%)+SHP |
| 4.21 | magaziniere | - | 1 | -//- | Vkm nr.177, p.19 | 35000 | (1%X30000)+35000 |
| 4.23 | sanitare/rrobalarese roje civile | - | 3 | -//- | Vkm nr.177, p.19 | 35000 | (1%X30000)+35000 |
| Çerdhja e qytetit (1+6) | | | | | | | |
| 4.25 | Pergjegjese e Cerdhes | Larte | 1 | K.Pune | Vkm nr.177, III-a/1, L.5 | 45200 | PG+(PGX2%)+SHP |
| 4.26 | Edukatore Çerdhe | Lartë Mesëm | 4 | -//- | Vkm nr.177, III-a/1, L.5 | 45000 39000 | PG+(PGX2%)+SHP (1%X30000)+39000 |
| 4.27 | Kuzhiniere cerdhes | Prof. | 1 | -//- | Vkm nr.177, p.19 | 35000 | (1%X30000)+35000 |
| 4.28 | Sanitare cerdhes | - | 1 | -//- | Vkm nr.177, p.19 | 35000 | (1%X30000)+35000 |

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Xhulia GJINI

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Greta LENA

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: -/-
Konfirmoi: -/-
Afati i ruajtes: RHK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Dr. B.M.J.
11.0

Nr. 711/ Prot.

Elbasan më 11.0. 2021

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.66 datë 28.05.2021 “Për një ndryshim të Vendimit nr.95 datë 28.12.2020 ‘Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh dhe njërive vartëse të saj, për vitin 2021”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj, me përjashtim të pikës 4.18 dhe 4.19 të tabelës nr.4 Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit sipas argumenteve më poshtë:

Në mbështetje të VKM –së nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, e ndryshuar, në lidhjen nr.3 janë përcaktuar nivelet bazë të pagave për punonjësit mësimorë të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve, ndërkohë që për përcaktimin e nivelit të pagës ju i jeni referuar VKM –së nr.165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” e ndryshuar, në pikën 7 të tabelës shtesa për pozicionin i kujdestarit të konviktit është 45200 lekë, ju e keni përcaktuar 45000 lekë.

Në VKM –në e referuar më lartë përkatësisht në tabelën nr.3 nuk është parashikuar pozicioni i përgjegjës së konviktit por vetëm ai i drejtorit të konvikteve, kujdestares dhe edukatores së konviktit, si rrjedhojë nuk ka nivel page të përcaktuar për këtë pozicion sipas këtij vendimi.

Në mbështetje të VKM –në nr.165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” e ndryshuar, për pozicionin përgjegjës sektori, në bazë të përshkrimit të punës, niveli i pagës mund të jetë III-b ose III a/1, në kategorinë II – b të pagës mund të përfshihet vetëm pozicioni

drejtor drejtorie. Niveli i pagës për përgjegjësin e konviktit është më i lartë se ai i përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, për pozicionin përkatës.

Për sa më sipër pikat 4.18 dhe 4.19 të tabelës nr.4 nuk konfirmohen pasi janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Konc: E. Zeneli

Konf: A.Grykshi

